



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar Auditimi Tematik të ushtruar në
"Bashkinë Kurbin".**

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMETIK

"BASHKIA KURBIN"

**Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020**

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 10
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit	10 - 12
II	HYRJA	12 - 16
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodot e auditimit. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16 - 34
III/1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	16 - 17
III/2.	Përkthimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	17 - 34
A.	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	34 - 39
V.	ANEKSET	39 - 49

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Audit i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Kurbin.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj. 600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“opinion të kualifikuar”**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1	Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 01.01.2020, paraqitet në vlerën 8,652,643 lekë, kurse në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 8,652,643 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	në vijim: Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: *Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar: a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, përkatësisht me VKM nr. 467, datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”. VKM nr. 114, datë 13.02.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Mamurras, të qarkut të Lezhës”. VKM nr. 307, datë 10.04.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fushë-Kuqe, të qarkut të Lezhës”.			konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë
2	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vitin 2019 paraqitet me 9,414,833 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 9,414,833 lekë, e cila tregon se edhe për këtë zë nuk ka patur ndryshime nga viti i kaluar, nuk është pasqyruar: a) Vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr.44, e cila përmban, listën e	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Kurbin, me numër rendor nga 1(një) deri 722 (shtatëqind e njëzet e dy), në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30 .			
3	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” më 01.01.2020, paraqitet në vlerën 1,245,739,476 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 798,402,372 lekë. Gjatë vitit 2020, kjo llogari është shtuar në vlerën 4,200,959 lekë, që përfaqësojnë vlerat e objekteve ndërtimore ekzistuese në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme. Bazuar në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike 381,201,523 lekë, sipas pasqyrës aneks nr.2. Ndërtime e konstruksione, Pasqyrat Financiare, viti 2020, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata “, përbërja dhe trajtimi kontabël, shkronja (b).	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt, rikonstruksion etj.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
4	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në vlerën 1,123,058,710 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore dhe shtuar gjatë vitit 2020 në vlerën 86,400 lekë, për Kolaudimin e rrugës në Cukall Sipas inventarit më 31.12.2020 rezulton në vlerën 1,387,080,922 lekë me kosto historike, të cilat përfaqësojnë vlerat e investimeve në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme. për rrugë, rrjete dhe vepra ujore. Amortizimi akumuluar deri më 31.12.2020, është 264,108,613 lekë, vlera kontabël neto është 1,123,058,710 lekë. *Bazuar edhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike 575,066,140 lekë, sipas Pasqyrës aneksit nr.3, Rrugë, rrjete vepra ujore, Pasqyrat Financiare, viti 2020. *Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Rrugëve rrjeteve dhe veprave ujore, me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, (sipas pasqyra aneksi nr. 3, “Ndërtim e konstruksione”, Pasqyrat Financiare, viti 2020), në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2,	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, duke shtuar në vlerën e tij fillestare vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për secilin objekt.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	“Aktivet afat gjata “, përbërja dhe trajtimi kontabël, shkronja (b).			
5	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në llogarinë 215“Mjete transporti”, e cila paraqitet në vlerën historike 94,297,431 lekë, nga kjo vlera prej 9,230,673 lekë është pasqyruar gabim për katër mjete transporti konkretisht: vlera prej 5,118,000 lekë që i përket dy mjeteve të transportit përkatësisht, mjeti tip “Rang Rover” me targë AA001DL, në vlerën 3,462,000 lekë dhe mjeti <u>Autoveturë me targë AA653PJ</u> në vlerën 1,656,000 lekë të cilat përdoren nga Shoqëria e Ujësllësit sha Laç. vlera 800,000 lekë që i përket mjetit tip Autobuz, në përdorim të Klubit të Futbollit Laç. vlera 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikës, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 “Mjete Transporti”, kur në fakt duhej kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 28”Caktime të aktiveve afatgjata” për vlerën 5,918,000 lekë të dy mjeteve në përdorim të Ndërmarrjes së Ujësllësit dhe të një mjeti në përdorim të klubit të futbollit si dhe në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, për mjetin e zjarrfikës që është i dëmtuar, jo në gjendje pune. Veprimi është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, shkronja “e” dhe shkronja (f).	E lartë	17-34	– Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore për sistemimin e veprimeve për AAGJM duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 24 “Aktive afat gjata të dëmtuara”, në vlerën 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikës, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. – Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për sistemimin kontabël të mjeteve të transportit, duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 28 "Caktime të aktiveve afatgjata", në vlerën 5,918,000 lekë, për 3 (tre) mjetet të cilat janë në kontabilitetin e Bashkisë, por në fakt janë në përdorim dhe administrim nga Ndërmarrja e Ujësllësit sha për dy mjete transporti dhe nga Klubi i Futbollit Laç, për një mjet transporti
6	Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020, Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 25,139,996 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 25,139,996 lekë dhe është e analizuar sipas	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues i njësisë vendore, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës 9,688,340 lekë sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore, të evidentuara në llogarinë nr. 466 “Kreditorë për mjete

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	objekteve për 32 raste, deri në momentin e verifikimit datë 02.07.2021 nuk është bërë çlirimi i garancive për vitin ushtrimor 2020. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet se për 28 subjekte në shumën 9,688,340 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2012-2020 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë çbllokimi i tyre. Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, <u>nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve</u>, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse sipas aneksit nr. 5 analiza e llogaris 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.			në ruajtje”, sipas aneksit nr. 5, bashkangjitur
7	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, gjendje më 01.01.2020 paraqitet në vlerën 117,344,259 lekë, është shtuar gjatë vitit në vlerën 35,865,401 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 153,209,401 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2020 Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se vlera 3,679,921 lekë e cila është gjendje më fillim dhe në fund të vitit 2020, nga Drejtoria e Financës nuk na u paraqit dokumentacion për analizën në mënyrë analitike. Të pyetur për këtë problem specialistët e financës sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat	E lartë	17-34	Bashkia Kurbin, drejtoria e Financës të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor qysh në origjinën e krijimit të tyre e sidomos të vlerës 3,678,921 lekë për të cilën mungon dokumentacioni i origjinës dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	financiare të ish Komunave qysh nga vitit 2015. Ky problem është trajtuar edhe në materialin e Auditit të mëparshëm të KLSH, i cili ka rekomanduar për gjetjen e origjinës nga vjen, arkëtimin e kësaj vlere, deri në padi në gjykatë, por aktualisht edhe gjatë këtij auditimi ende nuk është gjetur origjina se nga vjen dhe çfarë përfaqëson kjo shumë. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.			
8	Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, u verifikuan Aktivet Afatgjata Materiale, të llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm ku u konstatua se: Llogaria 210 “Toka Troje Terrene” për vlerën historike 8,652,643 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020, Llogaria 211 “Pyje Plantacione” për vlerën historike 9,414,833 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020. Llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, paraqitet vlere 798,402,372 lekë. Llogaria 213 “Rrugë, Rrjete, Vepra Ujorë “ për vlerën historike 1,387,080,922 lekë, është shtuar gjatë vitit 2020 për vlerën 86,400 lekë. Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajise” më 01.01.2020, paraqitet me kosto historike në vlerën 41,748,031 lekë dhe më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 43,037,980 lekë kosto historike, kurse vlere kontabël neto është 27,392,332 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe shtesat gjatë vitit 2020. -Në kontabilitet, janë mbajtur të analizuarat vlerat sipas objekteve të	E lartë	17-34	Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM), të verifikojë dhe saktësojë pronat të investuara prej saj ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të saj dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse, në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	investuara nga Bashkia Kurbin dhe të analizuar sipas vendndodhjes së tyre në vlerë sipas njësive Administrative. -Drejtoria e Financës nuk disponon të dhëna nëse është kryer inventarizimi fizik për Aktivet afat gjata materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. -Nga auditimi mbi regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vendore në pronësi të Bashkisë Kurbin, u konstatua se nuk janë kryer regjistrimet në pronësi dhe rrjedhimisht nuk kanë marrë certifikatën e pronësisë, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 9, 12, Kap. III dhe neni 23, pika 14, Kap. VII të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar. Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve afat gjata materiale, është në shkelje të kërkesave të pikave 74 dhe 96, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe pika 30, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.			
9	-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vitin 2020 paraqitet në vlerën kontabël 0 lekë. pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit. Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të	E lartë	17-34	– Bashkia Kurbin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”. – Drejtoria e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	cilave është në shumën totale 88,575,994 lekë. Gjithashtu llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 88,040,394 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 67,953,080 lekë, ku diferenca prej 20,087,314 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie vlera 12,161,158 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10 i Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42 e tij.			prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën 12,161,158 leke të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar**² për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Kurbin duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Kurbin, të vitit ushtrimor 2020, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Format nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Format nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Format nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Format nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore, Format nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Format nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Format nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Format nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Përshkrimi i çështjeve:

*Në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, nuk janë pasqyruar, vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të ndërtesave sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale dhe vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin.

*Në llogarinë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, nuk është pasqyruar, vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, pika 46, shtojca me nr.44, për 722 (shtatëqind e njëzet e dy),prona

*Në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve. Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike **381,201,523 lekë**.

*Në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*”, nuk është evidentuar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve. Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike **575,066,140 lekë**.

*Në llogarinë 215“*Mjete transporti*” është kryer kontabilizimi i gabuar për vlerën **9,230,673 lekë** që i përkasin katër mjeteve të transportit, të cilat duhej kontabilizuar përkatësisht në debi të llogarisë 28“*Caktime të aktiveve afatgjata*” për vlerën **5,918,000 lekë** të dy mjeteve në përdorim të Ndërmarrjes së Ujësjetllësit dhe të një mjeti në përdorim të klubit të futbollit si dhe në debi të llogarisë 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*”, për vlerën **3,312,673 lekë** mjetin e zjarrfikëses që është i dëmtuar, jo në gjendje pune.

*Në llogarinë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, nuk është sistemuar vlera **9,688,340 lekë**, pasi është garanci punimesh për 28 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet

² Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.

për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve.

*Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk justifikohet me dokumente analitike vlera **3,678,921 lekë**, gjendje më 31.12.2020, e trashëguar nga vitet e mëparshme, me pretendimin se është e trashëguar nga ish Komunitat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish Komunitat u përthithën nga Bashkia Kurbin, me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

*Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve afat gjatë materiale të llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare*” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kurbin.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financiare nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të kolauduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.06.2021 dhe autorizimit nr. 678/2, datë 14.6.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.06.2021 – 02.07.2021, në subjektin Bashkia Kurbin për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ, Përgjegjës grupi**
2. **H. I, Auditues**

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Kurbin .

b- Marrësi: Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Kurbin.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kurbin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kurbin.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Kryetari i Bashkisë Kurbin (*Nëpunësi autorizues*) **M. C.** dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) **E. K.**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Sipas përcaktimeve të pikës 6 e neni 34, neni 65- *Administrata e njësive administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e neni 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Kurbin dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatesia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

- *Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodatat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin³.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

³ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të

kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁴.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Kurbin, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Kurbin etj. akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Kurbin.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Kurbin, bën pjesë në Qarkun e Lezhës.



⁴ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Kurbin shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbin ka 46,291 banorë, ndërsa sipas regjistrit civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 172 banorë/km², ndërsa sipas Regjistrit Civil, densiteti është 271 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e re Kurbin shtrihet në një zonë bujqësore dhe pjesërisht malore në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe.

Kurbini gjendet përgjatë aksit rrugor dhe hekurudhor veri-jug, gjë që ka sjellë edhe zhvillimin e shërbimeve të transportit. Qyteti i Laçit, i cili ka një të tretën e popullsisë së bashkisë së re, është një zonë ish-industriale dhe është krijuar si qytet përreth fabrikave të Superfosfatit dhe të pasurimit të bakrit, që të dyja të mbyllura shumë kohë më parë. Fasoneria ka zëvendësuar këto fabrika si burimi kryesor i punësimit në qytet. Megjithatë, sot funksionon vetëm një fabrikë të prodhimit të këpucëve, ku janë të punësuar rreth 100 gra. Papunësia aktualisht në këtë bashki rezulton se është në nivele tepër të larta.

Pjesa tjetër e bashkisë është zonë bujqësore, ndërsa me rëndësi konsiderohet Laguna e Patokut, e cila është zhvilluar si zonë peshkimi dhe qendër e turizmit ditor.

Bimësia është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zonën e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishtave (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjekësore e aromatike, që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca.

Mbi marrjen e ndihmave ushqimore nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH)

Bashkia Kurbin ka përfutur ndihma ushqimore dhe ndihma pajisje inventari për shkak të COVID-19 dhe për pasojat e tërmetit të vitit 2019, nga donatorë të ndryshëm privat dhe shtetëror.

U auditua të gjitha ndihmat materiale dhe ushqimore të furnizuara nga DPRMSH Tiranë, për të cilat nga Bashkia janë dokumentuara për çdo rast furnizimi, janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje të rregullt, sipas fletë daljes së furnitorit.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene", nuk është pasqyruar vlera e trojeve nën objekt të ndërtesave të Bashkisë, të shkollave, të zyrave në njësitë Administrative si dhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin.

1. Titulli i gjetjes: Mos pasqyrim të vlerës së tokës truall nën objekt dhe të truallit funksional të ndërtesave sipas inventarit të tyre, në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene".
--

Situata:

Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 01.01.2020, paraqitet në vlerën 8,652,643 lekë, kurse në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 8,652,643 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim: Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: *Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar:

a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësiti Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”,

b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, përkatësisht me VKM nr. 467, datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr. 114, datë 13.02.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Mamurras, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr. 307, datë 10.04.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fushë-Kuqe, të qarkut të Lezhës”,

Kriteri:

-UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësiti e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”,

2. Titulli i gjetjes: Mos pasqyrim në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” të vlerës së pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë.

Situata:

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vitin 2019 paraqitet me 9,414,833 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 9,414,833 lekë, e cila tregon se edhe për

ketë zë nuk ka patur ndryshime nga viti i kaluar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pemë dekorative para vitit 2020, sipas aneksit në vijim:

Nr	Përshkimi i aktivit	Vlera
1	Peme dekorative Bli viti 2013	5,302,673
2	Peme dekorative viti 2014	3,812,160
	Total NjA Mamurras	9,114,833
3	Peme dekorative Rrap viti 2018	200,000
4	Peme dekorative Bli viti 2018	100,000
	Total llogaria 211 me 31.12.2019	9,414,833

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

*Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr.44, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Kurbin, me numër rendor nga 1 (një) deri 722 (shtatëqind e njëzet e dy).

*Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llogaria “Pyje, kullota, plantacione”, nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore.

Kriteri:

-UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nga kryerja e investimeve shtesë, si rikonstruksione dhe vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve.

3. Titulli i gjetjes: Mos pasqyrim të saktë të vlerës së çdo aktivi afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nga kryerja e investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit, në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”.

Situata:

-Gjendja në llogarinë **212 “Ndërtim e konstruksione”** më 01.01.2020, paraqitet në vlerën 1,245,739,476 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 798,402,372 lekë. Gjatë vitit 2020, kjo llogari është shtuar në vlerën 4,200,959 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

-Në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”, të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, paraqitet vlera 798,402,372 lekë, që përfaqësojnë vlerat e objekteve ndërtimore ekzistuese në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme. Nga analiza e vlerës së kësaj llogarie, bazuar edhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet të shtohen kostos fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike **381,201,523 lekë**, sipas pasqyrës aneks nr.2. Ndërtim e konstruksione, Pasqyrat Financiare, viti 2020, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa ‘b’.(Sipas Pasqyra Aneks nr.2, Ndërtim e konstruksione, Pasqyrat Financiare, viti 2020)

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa ‘b’.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 212 “Ndërtim e konstruksione”, për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt, rikonstruksion etj.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nga kryerja e investimeve shtesë, si rikonstruksione dhe vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve.

4. Titulli i gjetjes: *Mos pasqyrim të saktë të vlerës së çdo aktivi afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme, nga kryerja e investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit, në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”.*

Situata:

-Gjendja në llogarinë 213 “**Rrugë, rrjete vepra ujore**” më 01.01.2020 paraqitet në vlerën 1,182,080,662 lekë, më 31.12.2020 rezulton në vlerën 1,123,058,710 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore dhe shtuar gjatë vitit 2020 në vlerën 86,400 lekë, për Kolaudimin e rrugës në Cukall Sipas inventarit më 31.12.2020 rezulton në vlerën 1,387,080,922 lekë me kosto historike, të cilat përfaqësojnë vlerat e investimeve në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme. për rrugë, rrjete dhe vepra ujore. Amortizimi akumuluar deri më 31.12.2020, është 264,108,613 lekë, vlera kontabël neto është 1,123,058,710 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

*Bazuar edhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike 575,066,140 lekë, sipas Pasqyrës aneksit nr.3, Rrugë, rrjete vepra ujore, Pasqyrat Financiare, viti 2020.

*Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Rrugëve rrjeteve dhe veprave ujore, me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, (sipas pasqyra aneksi nr. 3, “Ndërtime e konstruksione”, Pasqyrat Financiare, viti 2020).

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata “, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa ‘b’. në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 213“Rrugë, rrjete vepra ujore”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të çdo aktivi.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 213“Rrugë, rrjete vepra ujore”, për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt, rikonstruksion etj.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, në llogarinë 215“Mjete transporti”, është pasqyruar gabim vlera 9,230,673 lekë, përkatësisht: a).Vlera 5,918,000 lekë që i përket dy mjeteve të transportit përkatësisht, mjeti tip “Rang Rover” me targë AA001DL, në vlerën 3,462,000 lekë dhe mjeti auto veturë me targë AA653PJ në vlerën 1,656,000 lekë të cilat përdoren nga Shoqëria e Ujësjetllësit sha Laç dhe vlera 800,000 lekë që i përket mjetit tip Autobus, në përdorim të Klubit të Futbollit Laç. b)Vlera 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikëses, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 “Mjete Transporti”,

5. Titulli i gjetjes: Pasqyrim i gabuar në llogarinë 215“Mjete transporti” të vlerës 9,230,673 lekë përkatësisht: a).Vlera 5,918,000 lekë të dy mjeteve të transportit të cilat

përdoren nga Shoqëria e Ujësjiellësit sha Laç dhe mjetit tip Autobus, në përdorim të Klubit të Futbollit Laç.

b). Vlera 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikëses, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 “Mjete Transporti”,

Situata:

-Gjendja e llogarisë **215“Mjete transporti”** në 01.01.2020 paraqitet në vlerën fillestare 94,297,431 lekë, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën fillestare 94,297,431 lekë dhe vlerë kontabël neto 41,026,952 lekë. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur shtesa ose pakësime.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton:

Në llogarinë 215“Mjete transporti” janë të evidentuara vlerat e mjeteve të transportit të cilat janë në inventarin e Bashkisë Kurbin dhe përdoren nga tre institucione, nga Bashkia Kurbin, nga Shoqëria e Ujësjiellësit sha Laç dhe nga Klubi i Futbollit të Laçit e konkretisht:

- vlera 85,066,758 lekë, i përket 19 mjeteve të transportit të cilat përdoren nga Bashkia Kurbin.

- vlera 5,118,000 lekë i përket 2 mjeteve të transportit të cilat përdoren nga ana e Ujësjiellësit sha Laç..

- vlera 800,000 lekë i përket 1 mjetit të transportit që përdoret nga Klubi i futbollit Laç.

- vlera 3,312,673 lekë i përket 1 mjetit të zjarrfikës që është jo në gjendje pune, i dëmtuar.

Në llogarinë 215“Mjete transporti” të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2020, e cila paraqitet në vlerën 41,026,952 lekë, nga kjo vlera prej 9,230,673 lekë është pasqyruar gabim për katër mjete transporti konkretisht:

- vlera prej 5,118,000 lekë që i përket dy mjeteve të transportit përkatësisht, mjeti tip “Rang Rover” me targë AA001DL, në vlerën 3,462,000 lekë dhe mjeti auto veturë me targë AA653PJ në vlerën 1,656,000 lekë të cilat përdoren nga Shoqëria e Ujësjiellësit sha Laç.

- vlera 800,000 lekë që i përket mjetit tip Autobus, në përdorim të Klubit të Futbollit Laç.

- vlera 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikëses, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 “Mjete Transporti”, kur në fakt duhej kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 28”Caktime të aktiveve afatgjata” për vlerën 5,918,000 lekë të dy mjeteve në përdorim të Ndërmarrjes së Ujësjiellësit dhe të një mjeti në përdorim të klubit të futbollit si dhe në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, për mjetin e zjarrfikëses që është i dëmtuar, jo në gjendje pune.

Inventari i llogarisë së mjeteve të transportit gjendje më 31.12.2020 paraqitet, sipas aneksit nr. 4 i Mjeteve të Transportit sipas llogarisë 215 “Mjete transporti” viti 2020.

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, germa “e” dhe germa “f”.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 215 “Mjete Transporti”.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore për sistemimin e veprimeve për AAGJM duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 24 “Aktive afat gjata të dëmtuara”, në vlerën 3,312,673 lekë që i përket mjetit të zjarrfikës, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Gjithashtu, të marrin masa për

sistemimin kontabël të mjeteve të transportit, duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 28 “Caktimi të aktiveve afatgjata”, në vlerën 5,918,000 lekë, për 3 (tre) mjetet të cilat janë në kontabilitetin e Bashkisë, por në fakt janë në përdorim dhe administruar nga Ndërmarrja e Ujësjellësit sha për dy mjete transporti dhe nga Klubi i Futbollit Laç, për një mjet transporti.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk janë marrë masa për likuidimin e vlerës **9,688,340** lekë, të cilat janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera për 28 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit sipas objekteve përkatëse.

6. Titulli i gjetjes: Mos marrje masash për likuidimin e vlerës **9,688,340** lekë, të pasqyruara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh për 28 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia.

Situata:

Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 25,139,996 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për vlerën 25,139,996 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 32 raste, deri në momentin e verifikimit datë 02.07.2021 nuk është bërë çlirimi i garancive për vitin ushtrimor 2020. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet se për 28 subjekte në shumën 9,688,340 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2012-2020 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë çbllokimi i tyre.

Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse sipas aneksit nr. 5 analiza e llogaris 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”.

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të detyrimeve të njësisë vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues i njësisë vendore, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës **9,688,340** lekë sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore, të evidentuara në llogarinë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas aneksit nr. 5, bashkangjitur .

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, për llogarinë **468 “Debitorë të ndryshëm”**, nuk janë marrë masa për të analizuar gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar

dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor qysh në origjinën e krijimit të tyre e sidomos të vlerës **3,678,921 lekë** për të cilën mungon dokumentacioni i origjinës dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre.

7. Titulli i gjetjes: *Mos marrje masash për të analizuar gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit dhe dokumentimin qysh në origjinën e krijimit të tyre për vlerën 3,678,921 lekë për të cilën mungon dokumentacioni i origjinës dhe për arkëtimin e vlerës së mësipërme.*

Situata: -Llogaria **468 “Debitorë të ndryshëm”** gjendje më 01.01.2020 paraqitet në vlerën 117,344,259 lekë, është shtuar gjatë vitit në vlerën 35,865,401 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 153,209,401 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2020

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

*Për vlerën 3,679,921 lekë e cila është gjendje më fillim dhe në fund të vitit 2020, nga Drejtoria e Financës nuk na u paraqit dokumentacion për analizën në mënyrë analitike. Të pyetur për këtë problem specialistët e financës sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave qysh nga vitit 2015. Ky problem është trajtuar edhe në materialin e Auditit të mëparshëm të KLSH, i cili ka rekomanduar për gjetjen e origjinës nga vjen, arkëtimin e kësaj vlere, deri në padi në gjykatë, por aktualisht edhe gjatë këtij auditimi ende nuk është gjetur origjina se nga vjen dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

*Shtesa në vlerën prej 35,865,142 lekë e kësaj llogarie gjatë vitit 2020, e cila përfaqëson detyrimet e bizneseve për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë e cila, sipas zërave paraqitet në vijim:

Aneksi i detyrimeve për taksa, tarifat të bizneseve, familjarë progresive deri 31.12.2020.

Nr.	Emërtesa	Vlera detyrimi
1	Bizneset	10,250,369
2	Urbanistika	14,014,77
3	IMTV	11,600,000
	Totali	35,865,142

Si përfundim konstatohet se:

*Në llogarinë **468 “Debitorë të ndryshëm”** të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2020, paraqitet në vlerën 153,209,401 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë për taksa dhe tarifa vendore të bizneseve, detyrimet e familjarëve për tarifa vendore. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se vlera prej 3,678,921 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish Komunitat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish Komunitat u përthithën nga Bashkia Kurbin, me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Kriteri:

UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e debitorëve të njësisë vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Bashkia Kurbin, drejtorja e Financës të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor qysh në origjinën e krijimit të tyre e sidomos të vlerës **3,678,921 lekë** për të cilën mungon dokumentacioni i origjinës dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre.

*Në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, për llogaritë e aktiveve afat gjata materiale nuk është kryer inventarizimi për vërtetësinë dhe saktësimin e pronave të investuara nga Bashkia ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë.

8. Titulli i gjetjes: *Mos kryerje e inventarizimit të aktiveve afat gjata materiale, për vërtetësinë dhe saktësimin e pronave të investuara nga Bashkia ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë.*

Situata:

Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, u verifikuan Aktivet Afatgjata Materiale, të llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm ku u konstatua se:

Llogaria 210 “Toka Troje Terrene” për vlerën historike 8,652,643 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020,

Llogaria 211 “Pyje Plantacione” për vlerën historike 9,414,833 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020.

Llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, paraqitet vlera 798,402,372 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë, Rrjete, Vepra Ujorë” për vlerën historike 1,387,080,922 lekë, është shtuar gjatë vitit 2020 për vlerën 86,400 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajise” më 01.01.2020, paraqitet me kosto historike në vlerën 41,748,031 lekë dhe më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 43,037,980 lekë kosto historike, kurse vlera kontabël neto është 27,392,332 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe shtesat gjatë vitit 2020.

-Në kontabilitet, janë mbajtur të analizuarat vlerat sipas objekteve të investuara nga Bashkia Kurbin dhe të analizuarat sipas vendndodhjes së tyre në vlerë sipas njësive Administrative.

-Drejtorja e Financës nuk disponon të dhëna nëse është kryer inventarizimi fizik për Aktivet afat gjata materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Nga auditimi mbi regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vendore në pronësi të Bashkisë Kurbin, u konstatua se nuk janë kryer regjistrimet në pronësi dhe rrjedhimisht nuk kanë marrë certifikatën e pronësisë, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 9, 12, Kap. III dhe neni 23, pika 14, Kap. VII të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve afat gjata materiale, është në shkelje të kërkesave të pikave 74 dhe 96, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe pika 30, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Kriteri:

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 74 dhe 96.

UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli III, pika 30.

Ndikimi/Efekti:

Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogaritë e AAGJM, nuk pasqyrojnë me vërtetësi ekzistencën e tyre fizike, të njësisë vendore.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor për inventarizimin e aktiveve afat gjata materiale dhe krahasimin me vlerën kontabël të llogarive AAGJM.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM), të verifikojë dhe saktësojë pronat të investuara prej saj ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të saj dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse, në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

9. Titulli i Gjetjes: *Mbi kontabilizimin e shpenzimeve të periudhave të ardhshme për kontratat e investimeve publike për vitin 2020.*

Situata:

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën kontabël 0 lekë. pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit.

Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 88,575,994 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:

-Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën kontabël për 88,040,394 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 535,600 lekë

Gjithashtu - Llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 88,040,394 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 67,953,080 lekë, ku diferenca prej 20,087,314 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga fatura të palikujduara të krijuara ndër vite dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2020 paraqitet si vijon:

Nr	Përshkrimi	Vlera
1	Investime	40,717,311
2	Vendime gjyqësore	12,161,158
3	FSHU	18,757,953
4	Ujësjiellës	2,187,582

Nr	Përshkrimi	Vlera
5	Posta	599,080
6	Sigurime shoqërore	2,687,805
7	Te tjera	10,929,505
	TOTAL	88,040,394

Konstatohet se vlera 12,161,158 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10 i Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuari i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të shpenzimeve të periudhave të ardhshme në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020.

Shkaku:

Zbatim i gabuar i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:

Nga Bashkia Kurbin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Gjithashtu Drejtoria e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën **12,161,158 leke** të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

*Gjatë auditimit u konstatuan llogari në aktiv dhe në pasiv të pasqyrave të pozicionit financiar të cilat janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore e konkretisht:

***Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

Për vitin 2020, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Kurbin me shkresën Nr. 2269 prot., datë 30.03.2021, konfirmuar nga dega e thesarit Kurbin me shkresën nr. 35 datë 30.03.2021 të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave. (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 1 e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2020*)

Veprimi është në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pikat 116, 118. Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2020, *paraqitet në aneksin nr.1 bashkangjitur*.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2020, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, konstatohet se:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. *Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi në se veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.*

Shuma e llogarive të paraqitura në postet e formatit nr. 1, pasqyra e pozicionit financiar, me informacionin që jepet në formatet anekse, si formati nr.7/b, “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata materiale , vlera neto”, formati nr.6, “Investimet dhe burimet e financimit”, formati nr.3, “Pasqyra e flukseve monetare (cash ‘floe)”, korrespondojnë ndërmjet tyre.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit si dhe nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, konstatohet se:

-Gjendja e llogarisë **520 “Disponibilitete në thesar”** në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitorë **1,099,755,582 lekë**. Referuar aktit të rakordimet me Degën e Thesarit Kurbin, kjo llogari **është për vlerën 1,099,755,582 lekë**.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimet me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020
1	Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”	1,099,755,582
2	Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	25,139,996
3	Llogaria 85”Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”	1,074,615,586

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” është e rakorduar **me të dhënat** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, duke pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor në vlerën **1,099,755,582 lekë, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.**

-Gjendja e llogarisë **202 “Studime dhe kërkime”** të grupit në “Aktivet afatgjata jo materiale” më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 19,849,053 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se gjendja më 01.01.2020 paraqitet me kosto historike në vlerën 40,600,264 lekë, në 31.12.2020, paraqitet në vlerën 37,218,661 lekë.

Kjo llogari është pakësuar në vlerën 3,381,603 e cila përfaqëson vlerën e studimeve dhe projekteve që i janë shtuar vlerës së investimeve të cilat janë bërë aktive, ndër vite sipas verifikimit të bërë për investime të kryera e cila përfaqëson sistemimin e kryer për kalimin e

studimeve dhe projekteve në vlerën e investimit përkatësisht në vlerën 1,093,248 lekë e cila kalon në llogarinë 212 (ndërtime konstruksione) dhe 2,168,755 lekë në llogarinë 213 (rrugë, rrjete dhe vepra ujore) si dhe 119,600 lekë në llogarinë 214 (makineri pajisje e instalime) sipas tabelave të mëposhtme:

Pasqyra e projekteve që kalojnë në vlerën e objekteve të investimeve të përfunduara.

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Projekt rruge lagjja nr 2,3,4 Laç	389,989
2	Projekt rruge dega ushtarake laç	55,857
3	Proj Rruga RZB –poliklinike	128,671
4	Projket Rruga Balator-vaj guri	61,320
5	Proj,Rruga e poliklinikes	79,995
6	Proj rruga lagjja nr 4	38,071
7	Proj ,rruga lagji nr 1	77,852
8	Projekt rruge laç	474,000
9	Projekt rruge 2014	360,000
10	Projekt ure lagjja Pavarsia Milot	216,000
11	Projekt ure Milot Lagjja Llozhe	192,000
12	Projekt rruga selite Milot	95,000
13	Proj terrene sportive	37,000
14	Proj pallati kultures	99,000
15	Studim fizibiliteti shkolla sanxhak	195,000
16	Supervizim kopshti nr 1	762,248
17	Superv kolaudim Ndricimi i qytetit	119,600
	Totali	3,381,603

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, në 01.01.2020, paraqitet në vlerën fillestare 77,805,876 lekë dhe më 31.12.2020, rezulton në vlerën fillestare 95,520,673 lekë, dhe vlerën kontabël neto 61,661,491 lekë, cila paraqet vlerën e blerjeve të kryera ndër vite dhe pakësuar për pjesën e amortizimit gjatë vitit 2020 sipas formatit nr. 7/b të pasqyrave financiare..

Për vitin 2020 -Gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pasqyrën aneks nr. 4)

-Gjendja e llogarisë 31 “Materiale” në “Aktivet Afat shkurtra ”, në 01.01.2020, paraqitet në vlerën 2,216,522 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 125,319 lekë e cila përfaqëson vlerën e materialeve të blera në vite dhe gjatë vitit të cilat janë gjendje në magazinë.

-Gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët” në “Aktivet Afat shkurtra” në 01.01.2020 paraqitet në vlerën 62,730,957 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 103,449,838 lekë e cila përfaqëson blerjet gjatë vitit 2020.

-Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 436,827,590 lekë e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 21”Aktive afat gjata materiale”. E detajuar kjo llogari për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Aneksi i Investimeve në proces gjendje më 31.12.2020. i rakorduar me thesarin.

N r	Llogaria Ekonomik e	Emërtimi i produktit	Buxheti 2020 ne leke	Fakti 2020	gjendja e papërdorur
1	6040000	Rindërtimi i objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare “Gjon Gjonaj	199,602,140	0	199,602,140
2	6040000	Rikonstrukcion i banesave individuale dhe njësie të banimit në ndërtesa (pallat)	927,544,728	476,800,000	450,744,728
3	6040000	Hartimi i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse	56,930,280	48,305,738	8,624,542
4	6040000	Shembja e objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti	65,164,800	49,800,000	15,364,800
5	6040000	Vendosje shpenzime operative kod teknik	296,969,254	0	296,969,254
		Totali	1,546,211,202	574,905,738	971,305,464

***Mbi hartimin dhe dorëzimin në thesar të pasqyrave financiare të konsoliduar.**

Në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduar për vitin 2020, të bashkisë Kurbin, bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion dhe sipas informacioneve të drejtorisë së Financës dhe të Burimeve Njerëzore, u konstatua se Bashkia Kurbin nuk ka njësi vartëse pasi i ka të shkruara në strukturën organizative si Agjenci të veçanta në përbërje të strukturës së Bashkisë, pa llogari më vete në thesar, për rrjedhojë nuk ka detyrim ligjor për të hartuar pasqyrat financiare të konsoliduar.

- Llogaritë e klasës katër në debit të tyre paraqiten në vijim:

-Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” (të drejta) në 01.01.2020, paraqitet në vlerën 99,001,819 lekë, më 31.12.2020 në vlerën 109,158,243 lekë, e cila rakordon me pasivin e bilancit për llogaritë e posh cituara.

Gjatë vitit 2020 vlera 109,158,243 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për paga ndaj personelit në vlerën 14,874,747 lekë, të pasqyruara në llogarinë 42”Personeli e llogari të lidhura me to”, sigurime shoqërore në vlerën 4,354,610 lekë të pasqyruara në llogarinë 435”Sigurime shoqërore”, sigurime shëndetësore në vlerën 583,319 lekë të pasqyruara në llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore” dhe detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa në vlerën 754,573 lekë të pasqyruara në llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”, vlera 535,600 lekë pagesë për këshilltarët për muajin dhjetor 2020 pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm” si dhe vlera 88,040,394 lekë pasqyruar në llogarinë 401-408 Furnitor e llogari të lidhura me to”.

• Transaksionet financiare për pagat, tatimin mbi pagë, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në lidhje me verifikimin e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të kontributit të sigurimeve shoqërore dhe të kontributit të sigurimeve shëndetësore, u përzgjedhën për auditim disa muaj e konkretisht, muajit Maj dhe Qershor të vitit 2020, nga ku u konstatua se: Bazuar në listë pagesat e vitit 2020, për muajin Maj dhe Qershor, të cilat janë të pasqyruara në përmbledhësen e listë pagesave të çdo muaji, u auditua përlllogaritja e detyrimeve për tatimin mbi pagë, detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe urdhër shpenzimet për likuidimin e këtyre detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe organeve tatimore. Përlllogaritja e detyrimeve dhe pagesat e tyre paraqiten në anekset në vijim:

VITI 2020

Aneksi i pagave sipas lista pagesave të muajit Maj 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Page Neto	Tatimi	sig shoqërore+supl	sig shëndetësore
1	1110	APARATI	5,268,427	268,096	1,546,131	214,222
2	10140	ÇERDHIJA	343,857	8,715	97,275	13,500

Nr	Prog	Emërtimi	Page Neto	Tatimi	sig shoqerore+supl	sig shendetsore
3	1170	GJENDJA CIVILE	311,738	21,483	91,936	12,758
4	4130	QKB	88,057	5,964	25,941	3,600
5	8140	SPORTET	619,668	20,475	176,616	24,510
6	8250	PALLATI	406,851	10,687	115,198	15,988
7	10910	PMNZSH	641,244	55,319	249,436	28,746
8	9120	ARSIMI PARASHKOLLOR	4,813,676	292,065	1,417,182	196,736
9	9230	ARSIMI MBESHTETES	776,695	37,263	224,575	31,160
10	4240	BORDI KULLIMIT	326,595	14,894	94,216	13,076
11	4520	RRUGET RURALE	676,741	8,620	185,398	25,730
12	4260	PYJORJA	78,612	4,345	22,888	3,176
13	1110	këshilltarët & k/fshatrave	433,260	80,340	0	
TOTALI			14,785,421	828,266	4,246,792	583,202

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga muaji Maj 2020

nr. USH	date	Objekti I shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
638-653	02.06.2020	Pagat e muajit maj 2020	7,038,598			
654-661	02.06.2020	Pagese Këshilltarësh maj 2020	433,260			
663-678	03.06.2020	Pagat e muajit maj 2020	7,313,563			
679-692	03.06.2020	Tatim +sig shoq., shend+suplem.		743,726	4,246,792	583,202
694	03.06.2020	Tatim keshillt +pensione		84,540		
TOTALI			14,785,421	828,266	4,246,792	583,202

Aneksi i pagave sipas lista pagesave të muajit Qershor 2020

Nr	Prog	Emërtimi	Page Neto	Tatimi	sig shoqerore+supl	sig shendetsore
1	1110	APARATI	5,292,226	273,977	1,551,814	214,950
2	10140	ÇERDHJA	343,857	8,715	97,275	13,500
3	1170	GJENDJA CIVILE	312,151	26,320	80,452	11,164
4	4130	QKB	88,057	5,964	25,941	3,600
5	8140	SPORTET	664,062	22,207	189,343	26,276
6	8250	PALLATI	406,851	10,687	115,198	15,988
7	10910	PMNZSH	642,192	55,233	249,237	28,724
8	9120	ARSIMI PARASHKOLLOR	4,830,302	295,156	1,423,007	197,545
9	9230	ARSIMI MBESHTETES	776,695	37,263	224,575	31,160
10	4240	BORDI KULLIMIT	326,595	14,894	94,216	13,076
11	4520	RRUGET RURALE	666,342	4,420	185,065	25,684
12	4260	PYJORJA	78,612	4,345	22,888	3,176
13	1110	këshilltarët & k/fshatrave	423,315	78,585	0	0
TOTALI			14,851,257	837,766	4,259,011	584,843

Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga muaji Qershor 2020

nr. USH	date	Objekti I shpenzimit	Llog 421	Llog 431	Llog 435	Llog 436
742-757	02.07.2020	Pagat e muajit qershor 2020	7,107,204			
758-766	02.07.2020	Pagese Këshilltarësh qershor 2020	423,315			
767-771	02.07.2020	Pagat e muajit qershor 2020	5,606,997			
771-782	03.07.2020	Pagat e muajit qershor 2020	1,713,741			
783-796	03.07.2020	Tatim +sig shoqer shendets+suplementare		752,150	4,259,011	584,843
798	03.07.2020	Tatim keshillt +pensione		85,616		
TOTALI			14,851,257	837,766	4,259,011	584,843

Gjithashtu u auditua transaksionet financiare për pagat, tatimin mbi pagë, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për muajin dhjetor 2020 të cilat likuidohen në janar të vitit 2021, nga ku u konstatua se:

Sipas listë pagesave të muajit dhjetor të vitit 2020, detyrimet për paga ndaj personelit janë në vlerën 14,874,747 lekë, nga përlllogaritjet rezulton se vlera e sigurime shoqërore zë vlerën 4,354,610 lekë, sigurime shëndetësore zënë vlerën 598,319 lekë dhe tatim mbi të ardhurat zënë vlerën 754,573 lekë, si dhe pagese këshilltarësh dhe k/pleq dhjetori 535,600 lek , të cilat janë likuiduar në muajin janar të vitit 2021 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse në vlerat e përcaktuara në pasqyrën e mëposhtme.

NR.	EMERTIMI	Dhjetor 2020
1	Paga Personeli (421)	14,874,747
2	Tatim page tatim ne burim (431)	754,573
3	Sigurimet Shogërore (435)	4,354,610
4	Sigurime Shëndetësore(436)	598,319
5	Pagese këshilltarësh	535,600
TOTALI		21,117,849

***Testim për rregullshmërinë e aplikimit të pagave dhe shtesave mbi pagë.**

U përzgjodhën për auditimin me zgjedhje për rregullshmërinë e pagave dhe shtesave, lista pagesat e muajit muajin Maj e Qershor të vitit 2020, për 10 persona paraqiten në *aneksin nr.6 bashkëlidhur materialit.*

Nga verifikimi me zgjedhje për rregullshmërinë e pagave dhe shtesave mbi pagë, për 10 persona për muajin Maj e Qershor të vitit 2020, sipas anekseve të mësipërme, nuk u konstatuan diferenca.

Për vitin 2020, pagat dhe shtesat janë në përputhje me VKM nr. 177 datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 165, datë 2.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe në VKB nr.57 datë 27.12.2019 "Për miratimin e pagës së punonjësve të bashkisë Kurbin, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020",

• Mbi evidentimin e konsumit të karburantit për vitin 2020 vazhdohet me normativat e vitit 2019 si vijon:

Me urdhër të ish Kryetarit të Bashkisë nr.2723, datë 27.05.2019 mbi “Caktimin e normativave të harxhimit të karburantit për vitin 2019” për të gjitha mjetet që disponon Bashkia Kurbin, sipas përmbledhës bashkangjitur urdhrit. Gjithashtu në periudha të ndryshme janë ngritur urdhër nga ish Kryetari i Bashkisë, janë mbajtur proces-verbale, nga komisionet përkatëse, si vijon:

Urdhër nr.1, datë 09.01.2017, për ngritjen e komisionit “Për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet me targa A..., A..., L..., A...”, ku është hartuar proces-verbal në datën 23.01.2017 dhe janë përcaktuar normativat për secilin automjet.

Urdhër nr.2, datë 09.01.2017, ngritje komisioni “Për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet me targa A..., A..., L..., A...”, është hartuar proces-verbal me datë 23.01.2017, ku janë përcaktuar normativat për automjet.

Urdhër nr.3, datë 15.02.2017, për mjetet : A..., A..., A..., A..., Volvo, proces-verbal datë 20.02.2017.

Urdhër nr.4, dt.24.04.2017, për mjetet me targa A..., A..., A..., A...J, A..., në datën 25.05.2017 është mbajtur proces-verbali përkatës.

Me VKB nr.172, datë 27.12.2018, është miratuar plani i harxhimit të karburantit për vitin 2019, konfirmuar me shkresën nr.1729/3, datë 26.12.2018 nga Prefektura Lezhë. Nga ish Kryetari i Bashkisë, janë lëshuar urdhër shërbime ditore, të nënshkruara nga titullari dhe nëpunësi udhëtues për udhëtimin e personave sipas natyrës së shërbimit, si dhe duke përcaktuar mjetin për të udhëtuar. Për çdo muaj është lëshuar urdhër magazinës nga ish Kryetari për sasinë e daljes së karburantit për secilin mjet. Për çdo muaj, është përgatitur përmbledhësja e udhëtimeve për çdo mjet transporti të firmosura nga nëpunësi udhëtues dhe drejtuesi i mjetit. Në këtë përmbledhëse të udhëtimit, janë shënuar edhe destinacioni i lëvizjes

dhe km rrugë të përshkuara, janë bërë edhe llogaritjet për konsum të karburantit sipas normativave të konsumit të miratuara nga komisioni i miratuar nga titullari i Bashkisë.

Për vitin 2020: Është vazhduar me të njëjtat normativa, si në vitin 2019. Me VKB nr.59, datë 27.12.2019, është miratuar plani i harxhimit të karburantit për vitin 2020, konfirmuar me shkresën nr.1738/3, datë 09.01.2020 nga Prefektura Lezhë.

Nga Kryetari i Bashkisë, janë lëshuar urdhër shërbime ditore, të nënshkruara nga titullari dhe nëpunësi udhëtues për udhëtimin e personave sipas natyrës së shërbimit, si dhe duke përcaktuar mjetin për të udhëtuar. Për çdo muaj është lëshuar urdhër magazinës nga Kryetari për sasinë e daljes së karburantit për secilin mjet. Për çdo muaj, është përgatitur përmbledhësja e udhëtimeve për çdo mjet transporti të firmosura nga nëpunësi udhëtues dhe drejtuesi i mjetit. Në këtë përmbledhëse të udhëtimit, janë shënuar edhe destinacioni i lëvizjes dhe km rrugë të përshkuara, janë bërë edhe llogaritjet për konsum të karburantit sipas normativave të konsumit të miratuara nga komisioni i miratuar nga titullari i Bashkisë.

- **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga biznesi i vogël, taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, për dhënie dokumente dublikatë nga arkivi Bashkisë, arkëtim gjoba të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2020, janë prerë MA të cilat fillojnë me nr.1, datë 08.01.2020, vlera 17,740 lekë dhe mbyllet me MA nr.160, datë 30.06.2020, vlera 5,000 lekë.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2020 janë 1,698,469 lekë, të cilat në çdo fund viti janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat.

- **Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.**

Për vitin 2020, u auditua urdhër shpenzimet e muajit qershor nga nr.631, datë 01.06.2020, vlera 13,828 lekë, deri te nr. 34, datë 25.06.2020, vlera 2,416,200 lekë.

Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues.

Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

*Për rastet e likuidimit të punimeve të ndërtimit, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhri për ngritjen e KVO-së, formulari

njoftim fituesi, buletini i APP për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni i punimeve të kryera, fatura e TVSh së subjektit përfitues, certifikata e përkohshme ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.

*Për rastet e blerjeve të materialeve të ndryshme, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhër për ngritjen e KVO-së, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi dhe njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e subjektit përfitues, proces verbali i marrjes në dorëzim dhe numri i fletë hyrje e magazinës.

*Për rastet e likuidimeve të shërbimeve e konkretisht të shërbimit të pastrimit të qytetit, të shërbimit të gjelbërimit, të shërbimit të varrezave të qytetit, të shërbimit të trotuareve, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur dokumentet si Situacioni i punimeve të kryera në fakt, fatura e TVSh së subjektit përfitues, kontrata e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit, proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve e shërbimeve.

Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar. Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

• **Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë.**

Gjatë vitit 2020, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.201 datë 22.10.2020 për ngritjen e komisionit të inventarizimit të elementëve të pasurisë së Bashkisë Kurbin, përfshirë këtu dhe njësitë administrative për vitin 2020. Pasi është mbajtur proces-verbali i vlerësimit, janë identifikuar materiale për nxjerrje jashtë përdorimit për inventarët e imët si vijon:

Nr	BASHKIA KURBIN	Llog 214	Llog 218	Llog 327	Totali
A	APARATI				
1	Bashkia Laç	45,000	1,179,416	1,777,131	3,001,547
2	Njësia Administrative Mamurras	0	114,538	43,140	157,678
3	Njësia Administrative Milot	40,000	265,780	10,200	315,980
4	Njësia Administrative Fushe-Kuqe	0	119,521	28,000	147,521
	Shuma	85,000	1,679,255	1,858,471	3,622,726
B	ARSIMI				
1	Shkollat Laç	330,392	7,992,570	7,155,182	15,478,144
2	Shkollat Njësia Administrative Mamurras	0	2,471,155	7,046,770	9,517,925
3	Njësia Administrative Milot	10,000	806,274	453,556	1,269,830
4	Njësia Administrative Fushe-Kuqe	0	182,628	889,313	1,071,941
	Shuma	340,392	11,452,627	15,544,821	27,337,840
	TOTALI	425,392	13,131,882	17,403,292	30,960,566

Më pas nëpërmjet urdhrave nr. 228, nr. 229, dhe nr. 230 datë 07.12.2020 është krijuar komisioni për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit të sipërcituar, veprime të cilat janë konfirmuar nga këshillit bashkiak me vendimin nr. 197 datë 24.12.2020.

Për shkak të të situatës të shkaktuar nga tërmeti i datës 26 nëntor të vitit 2019, nga ana e bashkisë është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objektet në pronësi të bashkisë Kurbin duke vlerësuar gjendjen për secilën prej tyre. Nga ana e komisionit është përgatitur një relacion “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të ndërtesave arsimore dhe godina e Bashkisë Kurbin” të cilat janë të konfirmuara me vendimin e KB nr 63 datë 22.04.2020 si vijon:

TABELE E NXJERRJEVE JASHTË PËRDORIMIT TË NDERTESAVE 2020							
Formular për nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesave arsimore							
Institucionet Arsimore	Shkolla 9-vjecare nr.5 Gjon Gjonaj,Lac	Shkolla 9-vjecare nr.4 Gjoke Elezi,Lac	Kopeshti nr .2 Laç	Shkolla e mesme,Mamurras	Shkolla 9-vjecare Dan Bajrami, Gjorm ,Mamurras	Kopeshti nr.1 Mamurras	Bashkia Kurbin
Pershkrimi I aktivitet	Ndertese arsimore	Ndertese arsimore	Ndertese arsimore	Ndertese arsimore	Ndertese arsimore	Ndertese arsimore	Ndertesa e Bashkise
Date e hyrjes ne perdorim	1996	1974	1998	1984	1970	1984	Vlera e Godines se Bashkise transf nga M.Bren) 2017
Vlera fillestare	58,691,904	35,260,640	27,981,024	73,879,260	54,530,000	15,039,000	75,156,574
Shpenzimet kapitale te kryera		49,339,763		3,686,634	479,626		15,472,459
Vlera e akumuluar e amortizimit							
Vlera e aktivitet në kontabilitet	58,691,904	84,600,403	27,981,024	77,565,894	55,009,626	15,039,000	90,629,033
Data e vlerësimit të nxjerrjes nga përdorimi	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020	VKB Nr.63 dt 22.04.2020
Personi/institucioni përgjegjës për administrim	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin	Bashkia Kurbin
Arsyet e nxjerrjes nga përdorimi	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019	Prishjes,se demtuar nga termeti dt 26.11.2019

Në analizë: Në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2020 sipas zërave, paraqitet në pasqyrën Aneks 2.1.1, bashkëlidhur Raport Auditmit.

Sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (grant) në shumën 2,691,642,246 lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo Njësi vendore në vlerën 29,069,918 lekë sipas aktit të rakordimet me Degën e Thesarit Kurbin. Përfshirja në këtë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhornuat nga drejtorja e taksave e tarifave vendore. Gjendja e secilës llogari të të ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura në llogarite analitike të aktit të rakordimet me degën e thesarit Kurbin

Për vitin 2020 totali i të ardhurave në vlerë është 2,729,818,267 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,655,202,681 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 1,074,615,586 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit

Për sa referuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

E. K. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Financës, për vitin 2020.

R. K., me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit, për vitin 2020.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: : Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 01.01.2020, paraqitet në vlerën 8,652,643 lekë, kurse në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 8,652,643 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim: Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: *Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar:

a)vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”,

b)vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, përkatësisht me VKM nr. 467, datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr. 114, datë 13.02.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Mamurras, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr. 307, datë 10.04.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fushë-Kuqe, të qarkut të Lezhës”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vitin 2019 paraqitet me 9,414,833 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 9,414,833 lekë, e cila tregon se edhe për këtë zë nuk ka patur ndryshime nga viti i kaluar, nuk është pasqyruar:

a)-Vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr.44, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Kurbin, me numër rendor nga 1(një) deri 722 (shtatëqind e njëzet e dy), në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

3.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” më 01.01.2020, paraqitet në vlerën 1,245,739,476 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 798,402,372 lekë. Gjatë vitit 2020, kjo llogari është shtuar në vlerën 4,200,959 lekë, që përfaqësojnë vlerat e objekteve ndërtimore

ekzistuese në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme.

Bazuar në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike **381,201,523 lekë**, sipas pasqyrës aneks nr.2. Ndërtime e konstruksione, Pasqyrat Financiare, viti 2020, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa ‘b’ (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione”, për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë materiale, duke shtuar në vlerën fillestare të aktivit, vlerën e shpenzimeve të investimit të ri për secilin objekt, rikonstruksion etj.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

4.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në vlerën 1,123,058,710 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore dhe shtuar gjatë vitit 2020 në vlerën 86,400 lekë, për Kolaudimin e rrugës në Cukall Sipas inventarit më 31.12.2020 rezulton në vlerën 1,387,080,922 lekë me kosto historike, të cilat përfaqësojnë vlerat e investimeve në vitet e mëparshme dhe të vitit ushtrimor, për investime të rikonstruksioneve të ndryshme. për rrugë, rrjete dhe vepra ujore. Amortizimi akumuluar deri më 31.12.2020, është 264,108,613 lekë, vlera kontabël neto është 1,123,058,710 lekë.

*Bazuar edhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë si, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Investimet shtesë që nuk i janë bashkuar vlerës së çdo aktivi deri më 31.12.2020 janë në vlerën historike 575,066,140 lekë, sipas Pasqyrës aneksit nr.3, Rrugë, rrjete vepra ujore, Pasqyrat Financiare, viti 2020.

*Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Rrugëve rrjeteve dhe veprave ujore, me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, (sipas pasqyra aneksi nr. 3, “Ndërtime e konstruksione”, Pasqyrat Financiare, viti 2020), në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa ‘b’. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, duke shtuar në vlerën e tij fillestare vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për secilin objekt.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

5.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, në llogarinë 215“Mjete transporti”, e cila paraqitet në vlerën historike 94,297,431 lekë, nga kjo vlera prej 9,230,673 lekë është pasqyruar gabim për katër mjete transporti konkretisht:

....vlera prej 5,118,000 lekë që i përket dy mjeteve të transportit përkatësisht, mjeti tip “Rang Rover” me targë AA001DL, në vlerën 3,462,000 lekë dhe mjeti Autoveturë me targë AA653PJ në vlerën 1,656,000 lekë të cilat përdoren nga Shoqëria e Ujësjiellitë sha Laç.

....vlera 800,000 lekë që i përket mjetetip tip Autobuz, në përdorim të Klubit të Futbollit Laç.

....vlera 3,312,673 lekë që i përket mjetetip të zjarrfikës, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar. Pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llogarinë 215 “Mjete Transporti”, kur në fakt duhej kryer regjistrimi dhe kontabilizimi në llogarinë 28“Caktim të aktiveve afatgjata” për vlerën 5,918,000 lekë të dy mjeteve në përdorim të Ndërmarrjes së Ujësjiellitë dhe të një mjeti në përdorim të klubit të futbollit si dhe në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, për mjetin e zjarrfikës që është i dëmtuar, jo në gjendje pune. Veprimi është në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2/1Trajtimi kontabël dhe rastet e daljeve të aktiveve afat gjata, germa “e” dhe germa “f”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore për sistemimin e veprimeve për AAGJM duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 24 “Aktive afat gjata të dëmtuara”, në vlerën 3,312,673 lekë që i përket mjetetip të zjarrfikës, i cili është jo në gjendje pune, i dëmtuar.

5.2.Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për sistemimin kontabël të mjeteve të transportit, duke kredituar llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe debituar llogarinë 28 "Caktim të aktiveve afatgjata", në vlerën 5,918,000 lekë, për 3 (tre) mjetet të cilat janë në kontabilitetin e Bashkisë, por në fakt janë në përdorim dhe administruar nga Ndërmarrja e Ujësjiellitë sha për dy mjete transporti dhe nga Klubi i Futbollit Laç, për një mjet transporti.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

6.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020, Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël **25,139,996 lekë**. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është për **vlerën 25,139,996 lekë** dhe është e analizuar sipas objekteve për 32 raste, deri në momentin e verifikimit datë 02.07.2021 nuk është bërë çlirimi i garancive për vitin ushtrimor 2020. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet së për 28 subjekte në shumën **9,688,340 lekë** gjenden në ngurtësuar fonde nga vitin 2012-2020 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë çbllokimi i tyre.

Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse sipas aneksit nr. 5 analiza e llogaris 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-50 të Projektraport të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues i njësisë vendore, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës **9,688,340 lekë** sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore, të evidentuara në llogarinë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas aneksit nr. 5, bashkangjitur .

7.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, gjendje më 01.01.2020 paraqitet në vlerën 117,344,259 lekë, është shtuar gjatë vitit në vlerën 35,865,401 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 153,209,401 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2020

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se vlera 3,679,921 lekë e cila është gjendje më fillim dhe në fund të vitit 2020, nga Drejtoria e Financës nuk na u paraqit dokumentacion për analizën në mënyrë analitike. Të pyetur për këtë problem specialistët e financës sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave qysh nga vitit 2015. Ky problem është trajtuar edhe në materialin e Auditit të mëparshëm të KLSH, i cili ka rekomanduar për gjetjen e origjinës nga vjen, arkëtimin e kësaj vlere, deri në padi në gjykatë, por aktualisht edhe gjatë këtij auditimi ende nuk është gjetur origjina se nga vjen dhe çfarë përfaqëson kjo shumë. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)*

7.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin, drejtoria e Financës të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor qysh në origjinën e krijimit të tyre e sidomos të vlerës **3,678,921 lekë** për të cilën mungon dokumentacioni i origjinës dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi.

8.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, u verifikuan Aktivet Afatgjata Materiale, të llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm ku u konstatua se:

Llogaria 210 “Toka Troje Terrene” për vlerën historike 8,652,643 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020,

Llogaria 211 “Pyje Plantacione” për vlerën historike 9,414,833 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2020.

Llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, paraqitet vlera 798,402,372 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë, Rrjete, Vepra Ujorë “ për vlerën historike 1,387,080,922 lekë, është shtuar gjatë vitit 2020 për vlerën 86,400 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajise” më 01.01.2020, paraqitet me kosto historike në vlerën 41,748,031 lekë dhe më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 43,037,980 lekë kosto historike, kurse vlera kontabël neto është 27,392,332 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe shtesat gjatë vitit 2020.

-Në kontabilitet, janë mbajtur të analizuarat vlerat sipas objekteve të investuara nga Bashkia Kurbin dhe të analizuarat sipas vendndodhjes së tyre në vlerë sipas njësisve Administrative.

-Drejtoria e Financës nuk disponon të dhëna nëse është kryer inventarizimi fizik për Aktivet afat gjata materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Nga auditimi mbi regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vendore në pronësi të Bashkisë Kurbin, u konstatua se nuk janë kryer regjistrimet

në pronësi dhe rrjedhimisht nuk kanë marrë certifikatën e pronësisë, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 9, 12, Kap. III dhe neni 23, pika 14, Kap. VII të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve afat gjata materiale, është në shkelje të kërkesave të pikave 74 dhe 96, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe pika 30, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

8.1 Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM), të verifikojë dhe saktësojë pronat të investuara prej saj ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të saj dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse, në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

9.Gjetje nga auditimi: -Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vitin 2020 paraqitet në vlerën kontabël 0 lekë. pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit.

Vlera debitorë e kësaj llogarie, **nuk është e kuadruar** me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 88,575,994 lekë.

Gjithashtu **llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 88,040,394 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 67,953,080 lekë, ku diferenca prej 20,087,314 lekë përfaqëson detyrimeve ndaj të tretëve për fatura të palikujduara gjatë vitit ushtrimor 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie **vlera 12,161,158 lekë duhet të kontabilizoheshin në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”** për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, si vijon:

Nr	Përshkrimi	Vlera
1	Investime	40,717,311
2	Vendime gjyqësore	12,161,158
3	FSHU	18,757,953
4	Ujësjiellës	2,187,582
5	Posta	599,080
6	Sigurime shoqërore	2,687,805
7	Te tjera	10,929,505
	TOTAL	88,040,394

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10 i Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42 e tij. (Më hollësisht trajtuar në faqe 17-34 të Raport Auditimit)

9.1. Rekomandim: Bashkia Kurbin, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”

9.2. Rekomandim: Drejtoria e financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën **12,161,158 leke** të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasivit të bilancit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT